



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Komisioneri**

Nr. 5/1 Prot.

Tiranë, më 6/9/ 2010

**Lënda:** Rekomandim lidhur me inspektimin administrativ të datës 12.08.2010

**Drejtuar:** Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë

**TIRANË**

Me datë 12.08.2010 nga grupi i inspektimit të zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë jush me cilësinë e kontrolluesit të përpunimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit tuaj, me objekt :

- A Njihet ligji nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ç’masa janë marrë për implementimin e tij.
- Ç’farë të dhënash përpunoni ( të dhëna personale, sensitive, biometrike etj.).
- Për këto të dhëna a zbatohen kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenet 5,6,7,8,9 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Ç’masa merren për sigurinë e të dhënave personale. Ku mbahen të dhënat dhe koha e mbajtjes së tyre.
- A përpunohen e transmetohen të dhëna për qëllime statistikore, gazetarie e literature. Nëse zbatohen kriteret e parashikuara në nenet 10 e 11 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Nëse kane rregullore të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale ose të ketë rregulla që janë përfshirë në rregulloren e brendshme.
- Nëse ka instalime të kamerave, si ato përdoren dhe a ka paralajmërim për përdorimin e tyre.
- A njihen të drejtat e subjekteve të të dhënave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe si zbatohen këto të drejta.
- Nëse e njohin detyrimin për të njoftuar të dhënat personale që përpunojnë, në ç’shallë dhe si veprohet.
- Nëse dhe në ç’masë zbatohen rregullat e konfidencialitetit për përpunimin e të dhënave personale.

Komisioneri Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ, të mbajtur me këtë rast dhe dokumentacionin provues të paraqitur nga ana e juaj, si dhe observacionin e mbajtur lidhur me shkeljet e evidentuara, konstaton :

1. Kontrolluesi ZVRPP Tirane nuk ka kryer detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
  - Nuk është zbatuar neni 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, “...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.
2. Ky Kontrollues në zbatim të neneve 27/2 “c” dhe 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” nuk është shprehur në rregulloret e brendshme të hartuara prej tij lidhur me mbrojtjen dhe konfidencialitetin për të dhënat personale.
  - Nuk është zbatuar neni 27/2 “c”... “udhëzon operatorët pa përjashtim për detyrimet që kanë në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë dhe rregullat për sigurinë e të dhënave”...
  - Nuk është zbatuar neni 28 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, “Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj”.
3. Kontrolluesi ZVRPP Tirane nuk ka kryer detyrimin ligjor për informim të punonjësve dhe subjekteve të të dhënave personale (që kryejnë aplikime dhe veprimtari tjera pranë këtij kontrolluesi) për përdorimin e sistemit të videosurvejimit.
  - Nuk është zbatuar neni 18 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, “...”Kontrolluesi kur mbledh të dhëna personale, duhet ta informojë subjektin e këtyre të dhënave...”

Për përmirësimin e gjendjes, mbështetur në nenet 29 dhe 30 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Komisioneri rekomandon këto masa :

1. Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” brenda datës 15 shtator 2010 të plotësojë detyrimin lidhur me njoftimin pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2. Në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Z.V.R.P.Palujtshme të përcaktohen rregulla të hollësishme për sigurinë e të dhënave që përpunohen, si dhe rregulla për ruajtjen e kofidencialitetit dhe të besueshmërisë të punonjësve që vihen në dijeni me përpunimin e të dhënave personale.
3. Të merren masat e nevojshme për vendosjen e tabelave paralajmëruese për sistemin e vëzhgim rregjistrimit me anë të kamerave, në ambientet ku kryejnë aplikimet dhe veprimet e tyre subjektet e të dhënave si dhe në ambientet e punës për punonjësit.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej tre muaj.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

